



Nr. Ref. BD-227/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M



- I. Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 29 maj 2025 dhe asaj me 16 qershor 2025 nëpërmjet këtij vendimi aprovohet si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.
- II. Ky vendim lryn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtura me 29 maj 2025 dhe asaj me 16 qershor 2025 Dokumenti aprovohet në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 qershor 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe në bazë të Rregullores Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në AKP-ë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anullohet konkursi për pozitën Drejtor Ekzekutiv nën nr. reference RN000165111 i AKP-së dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti/Divizioni i Burimeve Njerëzore të vazhdoj me publikimin e konkursit të ri të rekrutimit.
- III. Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Në mbledhjen e mbajtur me 30 qershor 2025, Bordi diskutoi lidhur me vendimin A. Nr. 682/2025 të KPMSHC të datës 17 qershor 2025 (pranuar në AKP me datë 26 qershor 2025 nr. protokoli 3095) dhe në zbatim të vendimit në fjalë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Bordi anuloi konkursin për pozitën Drejtor Ekzekutiv nën nr. reference RN000165111 i AKP-së

Bordi sipas procedurave pastaj vendosi për të rishpallur pozitën në mënyrë që të plotësohet pozita dhe të mos ketë vakum sepse kjo pozitë funksionon me u.d. nga 22.11.2024 e tutje. Duke marr parasysh atë që u tha më sipër vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/3

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 30 qershor 2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet amandamenti i akteve nënligjore sikurse në vijim: Procedurat e Shitjes dhe Metodologjia e Përcaktimit të Çmimit Orientues.
- II. Amadamentohet vendimi i Bordit BD-226-33 Shpallja ShAL 74 i datës 16.06.2025. Rrjedhimisht shpallja e ShAL 74 të bëhet me aktet nënligjore të aprovuara në këtë mbledhje.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për amadamentimin e akteve nënligjor të cekura në paragrafin I të këtij vendimi.

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktin se gjatë mbledhjeve të mëparshme të Bordit është diskutuara për faktin se si metodë e rritjes potenciale të numrit të ofertave do të ishte publikimi i çmimit orientues me rastin e publikimit të shitjeve me tender publik.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


X 
Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/4

Në bazë të nenit 15.2.1 dhe 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 15, paragrafët 2 dhe 3 i Statutit të Bordit të AKP-së, dhe Neni 10 i Ligjit Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 qershor 2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve aprovon kërkesën nga pala Valdete Cikaqi Gashi për qasje në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për vitet 2014 dhe 2019 lidhur me diskutimet e Bordit për Agrokosovën.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Divizionit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit lidhur me kërkesën e palës ekspertes gjyqësore Valdete Cikaqi Gashi për qasje në kopje të të gjitha procesverbaleve të Bordit të AKM dhe AKP ku është diskutuar çështja e Agrokosovës gjatë viteve 2014 dhe 2019.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DhPGJS) me datë 15 maj 2025 ka lëshuar Urdhërin nr. C-I-24-0021, që ka të bëjë me nxjerrjen e ekspertizës financiare lidhur me përmbushjen e zotimeve kontraktuale të privatizimit nga ana e Agrokosova Holding SHPK. Pala znj. Gashi pastaj me datë 11 qershor 2025 përmes e-mailit i është drejtuar Agjencisë me kërkesën për ofrimin e dokumentacionit përkatës, të cilin ajo e konsideron të domosdoshëm për hartimin e ekspertizës. Ndër të tjera ka kërkuar *Të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të AKM/AKP, ku është diskutuar çështja e Agrokosova Holding SHPK (ish-Veraria në Suharekë)*. Sekretaria ka komunikuar me palën dhe ia ka sqaruar që duke qenë se Agrokosova është privatizuar me 27 gusht 2007 nga AKM, pra rreth 18 vite më parë, dhe duke qenë se Bordi i AKM ka mbajtur 56 takime, ndërsa AKP deri tani 227 takime, dhe duhet të kontrollohet secila nga këto mbledhje andaj ka shumë volum dhe diskutime në shumë e shumë mbledhje për këtë çështje dhe duke pas parasysh Sekretaria i është drejtuar palës me email ku është kërkuar që të specifikoj nëse është e mundshme periudhën për të cilën kërkon procesverbalet dhe nëse pajtohet që të dërgohen procesverbalet kur janë diskutuar raportet e Auditimit dhe kur janë tërhequr aksionet. Pala është përgjigjur dhe ka kërkuar procesverbalet gjatë viteve 2014 dhe 2019.

Është analizuar Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, i cili në nenin 10 parasheh formën se si paraqiten kërkesat për qasje në dokumente publike, sipas nenit 15, paragrafi 2 i Statutit të Bordit, diskutimet në Bord duke përfshirë dhe votimin janë veprime konfidenciale të Bordit të Drejtorëve dhe se ato mund të behen publike vetëm autorizim të Bordi, dhe konsiderojmë se qasja lejohet vetëm pasi që Bordi të trajton kërkesën dhe të vlerëson arsyeshmëri dhe bazën juridike të kësaj kërkeje në raport me Statutin dhe Ligjin për qasje në dokumente publike. Ligji për qasje në dokumente publike e konsideron publik çdo dokument që prodhohet në një institucion publik, dhe u jep të drejta të gjera publikut për qasje në këto dokumente.

Ndërsa sipas nenit 15, paragrafi 3 i Statutit të Bordit, thuhet se në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, të bërë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, Bordi mund t'ia përcjellë kësaj pale kopjen e versionit të përmbledhur të procesverbalit të përshkruar në nenin 6, paragrafi 4 të Statutit.

MA




Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
Prishtinë,

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 qershor 2025




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/5

Në bazë të nenit 15.2.1 dhe 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 15, paragrafët 2 dhe 3 i Statutit të Bordit të AKP-së, dhe Neni 10 i Ligjit Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 qershor 2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve aprovon kërkesën nga pala Ferat Selimi për qasje në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për mbledhjet 16 maj 2025 dhe 16 qershor 2025 lidhur me diskutimet e Bordit për kërkesën e tij për shitje direkte.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Divizionit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit lidhur me kërkesën e palës Ferat Selimi për qasje në procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për mbledhjet 16 maj 2025 dhe 16 qershor 2025 lidhur me diskutimet e Bordit për kërkesën e tij për shitje direkte.

Pala Ferat Selimi përmes avokatit Arber Fazliu përmes shkresës nr. protokoli 3043 të datës 24 qershor 2025 ka kërkuar qasje në procesverbalet e sipër cekura dhe dokumentacionin e prezantuar. Sekretaria e Bordit po të njëjtën ditë e ka njoftuar Zëdhënësin e Agjencisë që nuk ka vendimmarrje në këtë rast dhe që në mbledhjen 16.06.2025 Bordi ka lëshuar udhëzim si në vijim:

-“Rasti pezullohet deri sa nuk vendoset lidhur me procesin e shpronësimit të iniciuar nga Komuna Skenderajit;

-Udhëzohet Menaxhmenti-DShD-ja që të njoftoj Komunën e Skenderajit që për pronën në fjalë të vazhdoj me procedurat shpronësimit”.

Sekretaria ka dërguar dokumentacionin e prezantuar tek Zëdhënësi, ndërsa lidhur me procesverbalet ka njoftuar se procesverbali i mbledhjes me datë 16 qershor 2025 akoma nuk ishte aprovuar nga Bordi, ndërsa në përgjithësi të dyja kërkesat për procesverbalet e sipërpërmendura dhe të gjitha rastet e ngjashme trajtohen në Bordin e Drejtorëve të AKP-së nëse duhet të jepet qasje palëve në procesverbal. Andaj kjo çështje është trajtuar në këtë mbledhje të Bordit.

Është analizuar Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, i cili në nenin 10 parasheh formën se si paraqiten kërkesat për qasje në dokumente publike.

Sipas nenit 15, paragrafi 2 i Statutit të Bordit, diskutimet në Bord duke përfshirë dhe votimin janë veprime konfidenciale të Bordit të Drejtorëve dhe se ato mund të behen publike vetëm autorizim të Bordit, dhe konsiderojmë se qasja lejohet vetëm pasi që Bordi të trajtoj kërkesën dhe të vlerësoj arsyeshmëri dhe bazën juridike të kësaj kërkeje në raport me Statutin dhe Ligjin për qasje në dokumente publike. Ligji për qasje në dokumente publike e konsideron publik çdo dokument që prodhohet në një institucion publik, dhe u jep të drejta të gjera publikut për qasje në këto dokumente.

MH.



Ndërsa sipas nenit 15, paragrafi 3 i Statutit të Bordit, thuhet se në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, të bërë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, Bordi mund t'ia përcjellë kësaj pale kopjen e versionit të përmbledhur të procesverbalit të përshkruar në nenin 6, paragrafi 4 të Statutit.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 qershor 2025




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores nr. 04/2025 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet plotësim ndryshimi i nenit 5.1 i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë për shtimin e numrit të Osh-ve nga njëzet (20) sa janë aktualisht në njëzet e pesë (25) OSH për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës; Autorizohet Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit;
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë për financimin e Ofruesve të Shërbimeve për nevojat e administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Ky vendim merret me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në mes të AKP dhe KGJK është konsideruar nga dy institucionet si e domosdoshme dhe me qëllim të përshpejtimit të proceseve të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe në përgjithësi ndihmës së ndërsjellë në mes të AKP dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 06 Dhjetor 2024 është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit për angazhimin e njëzet (20) Ofruesve të Shërbimeve/Juristë të diplomuar. Për shkak që aktualisht në Dhomën e Posaçme janë në proces numër i madh lëndëve gjyqësore në proces në raport me numrin e vogël të punonjësve dhe mundësive të kufizuar buxhetore të KGJK më datë 27 qershor 2025 KGJK ka dërguar kërkesë për shtimin e numrit të Osh-ve edhe për pesë (5) pozita në mënyrë që të rritet dinamika e punës së tyre dhe ngritja e efikasitetit.


Megjithatë Bordi ka udhëzuar Menaxhmentin që Memorandumi do të fillojë implementimin e Memorandumit në momentin që do të dërgohet raporti me të dhënat e punës së 20 OSh-ve të deritanishëm (raport ky që është dashur të dërgohet me 20.06.2025)


Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025.




Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/7

Në bazë të neneve Neni 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për shitjen e aseteve në likuidim dhe Procedurave të shitjes për shitjen e aseteve në likuidim, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet tërheqja nga procesi i shitjes nga ShAL 74 të njësive/aseteve si më poshtë:
Njësia 14 - Agroprodukti Toka në Hodonovc (Lot A)
Njësia nr. 28 - Zhivko Vasič Toka në Petroc (Lot D),
- II. Këto njësi do të qëndrojnë të tërhequra nga procesi i shitjes deri në një vendim tjetër të Bordit të Drejtorëve.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për tërheqjen nga lista e ShAL 74 dy asetet-njësitë e cekura në dispozitiv të vendimit. Bordi pati parasysh se kërkesat për tërheqjen nga shitja të njësive të sipërpërmendura janë të bazuara në arsyet si në vijim:


Më datë 26 qershor 2025, Kryetari i Komunës së Kamenicës Z. Kadri Rahimaj, përmes komunikimit zyrtar elektronik (e-mal), ka kërkuar tërheqjen nga shitja meqenëse këto asete janë për interes publik.

Duke marr parasysh të gjitha si më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Menor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/8

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), në mbështetje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e parashtrueses së kërkesës i autorizuar nga ku bartës i të drejtës banesore: Ivanka Radenovic me numër KB-1809/24 (4180) përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 18.06.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH RO "KBI- Kosova-Export"- Fushë Kosovë (PRN141).
- II. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banësive të datës 18.06.2025 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e parashtrueses së kërkesës: i autorizuar nga ku bartës i të drejtës banesore: për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH RO "KBI- Kosova-Export"- Fushë Kosovë (PRN141).

Bordi në pajtim me mandatin e tij shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që konstatoi se kërkesa e palës i plotëson kushtet ligjore për blerjen e banesës, dhe e cila shërben si bazë për realizimin e të drejtës banesore, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227-9

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-LMS 30 (0199) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.06.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "XIM Strezovci" Kamenicë (GJI066).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.06.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH "XIM Strezovci" Kamenicë (GJI066).

Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës nga pala si Vendimi për strehimin të përkohshme të punëtorit është i pamjaftueshëm për aprovim të kërkesës.

Andaj, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227-10

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247, Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Rregullores së Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës me numër KB-LMS 45/2007 (618) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 18.06.2025 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Kosova Tex" Prishtinë (PRN080).
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 18.06.2025 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSh "Kosova Tex" Prishtinë (PRN080).

Bazuar në nenin 7 paragrafi 2.1 të Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr.04/L-061, (tash e tutje referuar si "Ligji për Shitjen e Banesave") lidhur me kërkesën e palës janë vlerësuar të gjitha provat e dorëzuara në bashkëngjitje të kërkesës nga pala përfshirë edhe Aktvendimin e DHPGJSK ASC-10-0015-A0001 i datës 05.01.2015 e cila ka vendos vërtetë Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK SCC-06-0530 të datës 17dhjetor 2009, dhe që ta refuzoj ankesës kundër Aktvendimi. Gjithashtu Komisioni ka pranuar përgjigje në kërkesë për informata nga Drejtori i Departamenti i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjeve se prona e cila është objekt shqyrtimi në Komision është shitur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me datë 10.04.2006 dhe pronar është Andaj, Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6, lidhur me nenin 37 dhe 38 të ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga të lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/11

Në bazë të nenit 6.1.1, 6.1.2 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregulloren Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e qiramarrësit "Roni Fer" për realizimin e punimeve renovuese në objektin e ngrohtores brenda kompleksit të NSH "Metaliku".
- II. Qiramarrësi njoftohet se:
 - Punimet e realizuara janë në përgjegjësi të tij të plotë;
 - Asnjë kompensim apo rimbursim për investimet nuk do të kërkohej nga AKP;
 - Në rast të ndërprerjes së kontratës së qirasë, objekti duhet të mbetet në gjendje për t'u shfrytëzuar apo të jetë e shfrytëzueshme sipas dispozitave të kontratës së qirasë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Më datë 28.04.2025, qiramarrësi "Roni Fer" ka ripërsëritur kërkesën lidhur me nevojën për rikonstruksionin e objektit të kaldajës. Kërkesa përfshin: suvatimin e mureve të reja, shtrimin e dyshemesë me beton, dhe vendosjen e kulmit të ri. Sipas deklaratës së qiramarrësit qëllimi i këtyre punimeve është krijimi i hapësirave të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të biznesit të qiramarrësit.

Në përputhje me praktikën e mëhershme të Agjencisë dhe duke marrë parasysh faktin se qiramarrësi është i vetëdijshëm se për investimet e realizuara në pronën shoqërore nuk mund të kërkojë kompensim nga qiradhënësi, dhe duke qenë se investimet e tilla kontribuojnë në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së asetit, Bordi nuk ka kundërshtime për realizimin e këtyre punimeve, përderisa: qiramarrësi respekton kushtet e përcaktuara me kontratën e qirasë, qiramarrësi siguron të gjitha lejet e nevojshme nga organet kompetente komunale, punimet nuk cenojnë interesat apo aktivitetet e qiramarrësve të tjerë brenda kompleksit.


Agjencia nuk është përgjegjëse lidhur me sigurimin e lejeve përkatëse dhe se përmbushja e detyrimeve sipas kontratës së qirasë nuk do të ndikohet nga sigurimi i lejeve dhe dokumentet tjera përkatëse që kërkohej nga komuna. Këto dokumente janë të domosdoshme për të siguruar që punimet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe për të garantuar që ato nuk do të kenë ndikim negativ në aktivitetet e tjera brenda kompleksit.

Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padinë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Memor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/12

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobimet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të:
 - a) Tokës afariste, në të cilën është ndërtuar njësi ndihmëse e përdorur si tualet publik dhe autolarje, me sipërfaqe totale prej 119.55 m², e cila gjendet në Tregun me Shumicë – Zona Industriale, Prishtinë, dhe që është pronë e NSh “Tregu” (PRN104) në likuidim, me vlerë të përgjithshme të qirasë prej 152.00 € në muaj, për aplikuesin Eltion Uka.
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit është i detyruar të paguaj borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesi i kërkesës para nënshkrimit të kontratës së qirasë do të duhet të paguajë shumën si në vijim:
 - a) Tokës afariste, në të cilën është ndërtuar njësi ndihmëse e përdorur si tualet publik dhe autolarje – Tregu me Shumicë (Zona Industriale), parashtruesja e kërkesës Eltion Uka duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzim pa kontratë të qirasë për 2 muajt e kaluar (maj, qershor 2025) shumën prej € 304– respektivisht (152€/muaj × 2 muaj).
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.

Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar një (1) kërkesë zyrtare për qiradhënie direkte të një hapësire afariste (tokë), e propozuar për shfrytëzim si autolarje dhe tualet publik, në zonën e Tregut me Shumicë – Zona Industriale, Prishtinë.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë për asetet të cilat nuk kanë mundur ti sigurojnë herën e parë e vendim të DE 349/2024, prandaj bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në

M.H.



teren janë matur asetet e mëposhtme dhe çmimi i hapësirave të ofruar me qira tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale Prishtinë duhet të jetë sipas matjeve të paraqitura në raportin e vlerësimit.

Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohet që para nënshkrimit të kontratës të paguajnë shumën e qirasë në mënyrë retroaktive nga datat e poshtëshënuara për secilin prej tyre.


Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të paraqtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/13

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.5 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve; dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të ngastrave kadastrale 130/1 në sipërfaqe 1ha 73ari 30 m² dhe ngastrës kadastrale 130/2 me sipërfaqe 23ari 76 m² në pronësi të NSh Ereniku "Prodhimtaria Primare" PEJ029 në shumën e përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues në vlerën prej 1.636.12 Euro për një muaj kalendarik për parashtruesin e kërkesës Kompania Çuni SH.P.K.
- II. Aprovohet kërkesa e palës për ri programim të Borxhit ashtu që për periudhën retroaktive prej tri vitesh të kaluara do të paguajë shumën prej 58,900.32 € bruto, ashtu që për periudhën e ardhshme do të paguajë këtë shumë në 12 kështe
- III. Kontrata e qirasë do të lidhet me efektivitet nga data 01 korrik 2025.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.

Parcelat e lartcekura kanë qenë duke u shfrytëzuar nga Bashkim Podrimja pronar i Kompanisë Bash Mart, në të cilën i njëjti e ka vendosur gurëthyesin, që nga marsi i vitit 2002. Përkitazi me këtë është iniciuar padi për dorëzim në posedim në Gjykatë nga NSh Ereniku Prodhimtaria Primare, në Gjakovë dhe Gjykata ka marrë vendim me datë 23.06.2004. Pastaj me datë 30.07.2004 NSh Ereniku Prodhimtaria Primare ka iniciuar propozimin për përmbarim në vlerë prej 5,600 € për periudhën prill 2002–korrik 2004, kjo lëndë ende nuk është ekzekutuar. Në seancën e fundit të mbajtur me datë 05.04.2018 është bërë dalja në terren dhe është udhëzuar debitori që të bëjë lirim të pronës së NSh-së. Me datë 27.03.2018 pala ka parashtruar kërkesë për hyrje në marrëdhënie kontraktuale ku cek që është i gatshëm që të paguajë shumën prej 5,900 € për periudhën 2002-2004 si dhe borxhin e kalkuluar nga 2004 e deri qershor 2018.

Pasi që është bërë vlerësimi i qirasë për palën, i njëjti nuk e ka nënshkruar kontratën, AL-ja ka vazhduar procedurën gjyqësorë ndaj palës, gjithashtu ka bërë hulumtime paraprake për largimin e gurëthyesit nga prona e NSh-së por pasi që kostoja ka qenë e lart (rreth 60,000.00 Euro) për angazhimin e një kompanie e cila do të largonte gurëthyesin, AL-ja ka vazhduar me proces gjyqësor i cili ende nuk ka përfunduar. Gjatë vizitës në teren nga zyrtari i rastit është vërejtur se në ngastrat e lartcekura është duke operuar Kompania "Çuni" Sh.p.k e cila e ka konfirmuar që gurëthyesin e ka blerë nga ish uzurpatori Bashkim Podrimja dhe se është i interesuar që të hyjë në marrëveshje kontraktuale me AKP-në për tokën respektivisht për ngastrën 130/1 në sipërfaqe 1ha 73ari 30 m² dhe ngastrës kadastrale 130/2 me sipërfaqe 23ari 76 m² me kulturë livadh, me sipërfaqe të përgjithshme 1 ha 97 ari 6 m² që ndodhen në Zk Zidi i Sadik Ages I.

MAH



Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesit e këtyre kërkesave, tanimë edhe shfrytëzuesit e këtyre hapësirave do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Prona e cila do të vlerësohet për dhënie me qira, sipas dokumentacionit të poseduar nga AKP, ZR Prishtinë, dhe sipas listës së aseteve, është tokë afariste përkatësisht treg.



Kësisoj, Autoriteti i Likuidimit konsideron që është e arsyeshme dhe legjitime që në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën nga data kur secili ka hyrë në shfrytëzim të këtyre hapësirave. Andaj, nga palët do të kërkohej që të paguaj shumën e qirasë 58,900. 32 € në mënyrë retroaktive për tri (3) vite deri në momentin e nënshkrimit të kontratës. Kjo shumë do të paguhet sipas mënyrës së ri programimit të borxhit.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.4 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 19,669 m² të ngastrës kadastrale 00366-5 ZK Suhadoll në pronësi të NSh "KB Kosova" PRN082, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 2,360.00,28 për një muaj kalendarik për parashtruesin e kërkesës VIVA Fresh Sh.P.K.
- II. Refuzohet kërkesa për qiradhënie për ngastrën kadastrale 0366-7 ZK Suhadoll pasi që kjo parcelë në certifikatat pronësore aktuale evidentohet si pronësi private.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

Me datën 05.06.2025 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar kërkesën nga "VIVA Fresh" Sh.P.K. me që të i'a mundësojë qiramarrjen e ngastrave kadastrale të lartëcekura. Vendndodhja e pronës është në ZK Suhadoll. Fillimisht kërkesa është paraqitur për ngastrat 00366-5 dhe 00366-7 ZK Suhadoll, mirëpo ZR Prishtinë kur ka filluar përgatitjen e raportit të vlerësimit ka kuptuar se ngastra 0366-7 ZK Suhadoll është ngastër në pronësi private që nga vitet e 80-ta dhe kjo ngastër nuk mund të vlerësohet dhe aprovohet për qiradhënie nga AKP. Pjesë e shkresës është edhe letra mbështetëse e paraqitur nga ana e KK Gracanice qw wshtw nw pwrputhje me nenin 10.1.4 të rregullres 03/2025 për qiradhënie.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit 982/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për parcelat e lartëcekura me sipërfaqe prej 19,669 m² është në shumën prej 2.360.00,28 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

MA.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.3 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënien direkte respektivisht kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për të dhënë me qira Organizatës Cultural Heritage Without Borders - ChwB hapësirën në katin e shtatë, lamela A pronë e NSH NewCo Grand Hotel, PRN173, me çmimin total prej 150.00 Euro/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

NSH NewCo Grand Hotel, ka filluar procedurën e likuidimit nga data 02.02.2015.

Me datë 16.06.2025, AKP, ka pranuar një kërkesë të parashtuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilët kanë kërkuar që Organizatës Cultural Heritage without Borders - ChwB të i mundësohet marrja me qira e hapësirës ekspozuese në katin e shtatë të lamelës A në NewCo Grand Hotel për shumën prej 150.00 EUR/muaj për zhvillimin e programit "Heritage Space". Hapësira në katin e shtatë është afërsisht 395 m² dhe aktualisht është vetëm në beton dhe e pashfrytëzueshme dhe poashtu edhe lifat që dërgojnë në këtë pjesë nuk janë në gjendje aq të mirë.

Në këtë rast Ministria e ka paraqitur kërkesën me qëllimin që të i mundësohet ChwB lidhja e kontratës së qirasë me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve kulturore në shumën prej 150.00 EUR/muaj.

Pasi që parashtues i kërkesës është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit konform nenit 10 par.3 të Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aset i do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik dhe pasi që bie në kuadër të nenit 10 par. 1.3 dhe është organizatë jofitimprurëse nga lëmia e kulturës atëherë ndoshta mund të pranohet edhe kërkesa dhe arsyetimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të paguhet shuma prej 150.00 EUR/muaj për shkak edhe të limiteve buxhetore që ka kjo organizatë.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat e NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

M.H.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



X

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/16

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; nenit 10. 1.4 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënien direkte të sipërfaqes prej 200,914 m² të parcelave kadastrale: 150-2; 151-0; 152-0; 153-0; 154-0; 156-0; 157-0; 158-0; 159-0; 160-0; 161-0; 162-0; 163-0; 164-0; 165-1; 165-2; 165-3; 167-0; 168-0; 169-0; 170-0; 171-1; 171-2; 171-3 dhe 172-0 ZK Fushë Kosovë në pronësi të NSh "KB Bujqësia" PRN009, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 8,131.00 për një muaj kalendarik për palën Qami Construction me përfaqësues Qazim Sylaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.

Vendndodhja e pronës është në ZK Fushë Kosovë. Më datë 16.06.2025, pala ka dorëzuar shkresën me nr. protokollit 26587/2025 ku ka bërë korrigjimin e kërkesës së parashtruar më datë 20.05.2025 dhe kërkon qiramarrjen e ngastrave kadastrale: 150-2; 151-0; 152-0; 153-0; 154-0; 156-0; 157-0; 158-0; 159-0; 160-0; 161-0; 162-0; 163-0; 164-0; 165-1; 165-2; 165-3; 165-01; 167-0; 168-0; 169-0; 170-0; 171-1; 171-2; 171-3 dhe 172-0 ZK Fushë Kosovë.

Për ngastrën kadastrale 165-01 Agjencia nuk ka asnjë të dhënë dhe nuk figuron në gjendjen teksutale dhe poashtu as nuk gjendet në listën e asetëve të NSh-së dhe kjo ngastër nuk hynë në pjesën e propozimit për aprovim të qiradhënies. Më datë 26.05.2025 pala ka sjellë edhe letrën mbështetëse nga ana e KK Fushë Kosovë, ku ofrohet mbështetja apo përkrahja e kësaj Komune sa i përket planit për zhvillim të biznesit që Kompania Qami Construction ka në këtë rast. Poashtu, më datë 27.05.2025, të njëjtit kanë dorëzuar edhe planin e biznesit që do të zhvillohet në këto parcela, e ku është kryesisht në prodhimin e materialeve të ndryshme, të cilat do të përbehen nga dy parqe industriale. Për më tepër, më datë 19.06.2025 kanë dorëzuar edhe shkresën me nr. protokollit 26605/2025, ku është edhe letra mbështetëse nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, ku kanë theksuar përkrahjen e plotë në raport me projektet e kompanisë Qami Construction Sh.P.K.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 988/2025 të u.d. Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për parcelat e lartëcekura me sipërfaqe prej 200,914 m² është në shumën prej 8,131.00 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat e NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025




Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/17

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë me nr. protokoli 2681 dhe 2682 në mes të AKP duke vepruar në emër të NSh Ina Tregovina Zagreb dhe nenit 2.5 të kontratave të mëvonshme të lidhura në mes të AL-së së NSh "Ina Tregovina Zagreb" dhe NIKI S Group, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratave të qirasë nga NIKI S Group Sh.P.K. tek Petrol Company Sh.P.K.:
 - a) Kontratës së qirasë së lidhur më datë 13/04/2017 me nr. protokoli 2681 e vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokoli 46878/2023, objektit të pompës së derivateve me të gjitha asetet përcjellëse të ndërtuara në parcelën kadastrale 4501-6 ZK Gjakovë (Gjakovë – Qendër) në shumën prej 2,100.00 Euro (bruto) për një muaj kalendarik;
 - b) Kontratës së qirasë së lidhur më datë 13/04/2017, me nr. protokoli 2682 e vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokoli 46879/2023, objektit të pompës së derivateve me të gjitha asetet përcjellëse të ndërtuara në parcelën kadastrale 4351-2 ZK Gjakovë (tek ish fabrika e kompresorëve) në shumën prej 2,800.00 Euro (bruto) për muaj kalendarik.
- II. Obligohet pala Petrol Company Sh.P.K. që brenda periudhës deri në 12 muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, të paguajë, përpos qirasë mujore, edhe pjesën e borxhit për secilën nga kontratat si në vijim:
 - a) Për kontratën e qirasë nga paragrafi a) i pikës I të këtij dispozitivi, për të cilën shuma totale e borxhit deri në qershor 2025 është në vlerën prej 47,600.52 Euro të paguajë të paktën 3,966.71 Euro për muaj kalendarik;
 - b) Për kontratën e qirasë nga paragrafi b) i pikës I të këtij dispozitivi, për të cilën shuma totale e borxhit deri në qershor 2025 është në vlerën prej 63,272.95 Euro, të paguajë të paktën 5,272.74 Euro për muaj kalendarik.
- III. Pas arritjes së kësaj marrëveshje, Autoriteti i Likuidimit do të obligohet të tërheqë propozimet për përmbarim të inicuar për shkak të borxhit dhe obligohet pala Petrol Company Sh.P.K. që të paguajë të gjitha shpenzimet në lidhje me procedurën përmbarimore të inicuar të cilat i ka pasur AL-ja e të cilat palës do të i bëhen me dije me vonë, pas konfirmimit nga ana e Përmbaruesit Privat.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

NIKI S Group është qiramarrës i dy pikave të karburanteve të cilat janë në pronësi të NSh "Ina Tregovina Zagreb, saktësisht pikave të karburanteve të ndërtuara në parcelën kadastrale 4351-2 ZK Gjakovë (te ish fabrika e kompresorit) dhe parcelën kadastrale 4501-6 ZK Gjakovë (Gjakovë – Qendër). Kontratat e qirasë janë nënshkruar për herë të parë me 13.04.2017. Këto kontrata që nga koha e lidhjes janë vazhduar pa ndërprerje deri me datë 31.05.2025. Ky aset ka hyrë në qiradhënie para se NSh të hyjë në likuidim.

Më 10.06.2025 ZQ AKP-se ka pranuar shkresën me nr. Prot: 2823, nga përfaqësuesi i NIKI S Group Sh.P.K. të cilët kanë kërkuar që kontratat e lartcekura të qirasë të transferohen së bashku me të gjitha obligimet tek Petrol Company Sh.P.K. Në shkresë kanë bashkëngjitur edhe marrëveshjen në mes të palëve të lartcekura për bartje të kontratës së qirasë dhe poashtu është bashkëngjitur një deklaratë zyrtare nga ana e Petrol Company Sh.p.k. të cilët



marrin përsipër që të bëjnë pagesën e borxhit total që ka qiramarrësi, mirëpo ky borxh të ju mundësohet që të paguhet me këste deri në 12 muaj.

Arsyeja pse pala NIKI S Sh.P.K. ka hyrë në borxhe dhe arsyeja pse kanë parashtruar kërkesën për transferim të kontratës së qirasë deklarohet të jetë vështirësitë financiare për shkak të trajtimit shëndetësor të anëtarëve të familjes.

Shuma totale e borxhit tek aneksi i qirasë me nr. protokolli 46878/2023 apo për pikën e karburanteve në Gjakovë-Qendër është 47,600.52 Euro. Për pikën e karburanteve tek ish fabrika e kompresorëve në Gjakovë e vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokolli 46879/2023 është në shumën prej 63,272.95 Euro.

Autoriteti i Likuidimit ka ndërmarrë disa veprime në raport me shumën e borxhit, ku ka kërkuar nga ana e palës disa herë që të kryhen pagesa, mirëpo pa rezultat dhe vetë pala është paraqitur në ZR Prishtinë duke sqaruar se ka vështirësi financiare për arsye se janë duke u përballuar me probleme shëndetësore të anëtarëve të familjes. Për një pjesë të borxhit është iniciuar procedura përmbartimore dhe rast është në gjykatë dhe ende pa vendim, pasi që pala ka parashtruar prapësim ndaj propozimit për përmbartim.

Në këtë rast edhe pse është iniciuar procedura e përmbartimit, Bordi konsideron që do të ishte një zgjidhje e dyanshme e arsyeshme edhe për NSh-në që përmes kësaj marrëveshje të inkasojë të hyra në vlera të larta brenda periudhës një vjeqare. Në këtë rast, përpos të hyrave mujore do të mundësohet edhe inkasimi i borxhit total tek të dy kontratat të qirasë për periudhën 12 mujore.

Në këtë rast edhe zotimi i dhënë nga pala Petrol Company Sh.P.K. në lidhje me marrjen përsipër të obligimeve financiare mund të konsiderohet si i ligjshëm dhe mund të merret parasysh duke u bazuar në nenin 127 të Ligjit për Marrdheniet e Detyrimeve, ku parashihet që *“Secila palë në kontratën dypalëshe mundet po qe se për këtë jep pëlqimin pala tjetër t’ia cedojë kontratën personit të tretë i cili me këtë gjë bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tij që dalin nga kjo kontratë”*.

Petrol Company Sh.P.K. do të jetë e obliguar që për 12 muaj të fshijë total shumën e borxhit të lartëcekur.

Autoriteti i Likuidimit wshtw i obliguar që të tërhiqet nga procedura përmbartimore, mirëpo Bordi konsideron se është e arsyeshme që nga pala Petrol Company Sh.P.K. të kërkohej të paguhet të gjitha shpenzimet përmbartimore që AL ka pasur në emër të inicimit të procedurës për borxhin e mbetur. Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi aktual ka një kohë të gjatë që është qiramarrës dhe deri tek borxhi i lartë ka ardhur si pasojë e vështirësive financiare të papritura për të

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


X
Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/18

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokoli 12520/2017 në mes të "NSHBQ Drenica", Drenas/Glllogoc dhe NP Autoshtëpia; Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e objektit-depos univerzale në Rr. Fehmi dhe Xhevë LLadrovci pn, Zona Kadastrale Çikatovë e re, Komuna e Drenasit/Glllogocit me sipërfaqe prej 1322.5 m², me qira mujore prej 350.00 EUR nga "NP Autoshtëpia (Haki Bajraktari)" tek "Autoshtëpia NB sh.p.k" me përfaqësues Nexhmedin Bajraktari.
- II. Obligohet pala që para nënshkrimit të kontratës së qirasë sipas kërkesës për transfer të paguajë pjesën e borxhit në shumën prej 350.00 Euro.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

Ndërmarrja Shoqërore "NSHBQ Drenica", Drenas/Glllogoc (në likuidim) ka filluar likuidimin me datën 09.06.2014. Autoriteti i Likuidimit i kësaj ndërmarrje menaxhon me asetet e mbetura, kryesisht toka bujqësore dhe disa objekte të cilat janë duke u lëshuar me qira.

Haki Bajraktari është Qiramarrës i objektit afarist – depo univerzale në Rr. Fehmi dhe Xhevë LLadrovci pn, Zona Kadastrale Çikatovë e re, Komuna e Drenasit/Glllogocit me sipërfaqe prej 1322.5 m² që nga dt. 11.01.2007 e tutje. Më 11.06.2025 Zyra Rajonale e Mitrovicës ka pranuar shkresën me nr. Prot: 5602/2025, nga personi fizik Nexhmedin Bajraktari i cili kërkon që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga "NP Autoshtëpia (Haki Bajraktari)" tek "Autoshtëpia NB sh.p.k" me përfaqësues Nexhmedin Bajraktari.

Kjo kontratë është rivlerësuar nga Bordi. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes ka vazhduar pa ndërprerje deri më sot, si dhe qiramarrësi aktualisht ka borxh në shumën prej 350.00 Euro bruto të cilat do të jetë i obliguar të paguajë para nënshkrimit të kontratës sipas vendimit mbi transferim të kontratës së qirasë.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit te pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi aktual ka një kohë të gjatë që është qiramarrës dhe deri tek borxhi i lartë ka ardhur si pasojë e vështirësive financiare të papritura për të. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/19

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSH Tregu:
- a) Nga Muharrem Beqiri si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr.20A, Tregun me Shumicë (Tekstil) me sipërfaqe prej 79 m², transferohet qiraja si qiramarrës i tokës në emër të BEQA Sh.P.K., me numër unik identifikues 810544488, përfaqësuar nga Muharrem Beqiri, në shumën prej 157.00 Euro/muaj;
 - b) Nga Sali Beqiri si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr.14A, Tregu me Shumicë (Tekstil) me sipërfaqe të përgjithshme prej 187 m², transferohet qiraja si qiramarrës i tokës në emër të BEQA Sh.P.K., me numër unik identifikues 810544488, në shumën prej 371.00 Euro/muaj;
 - c) Nga Gentrit Hetemi si qiramarrës i lokalit afarist nr.9 në Tregun me Shumicë (Tekstil) sipërfaqe prej 100 m², në emër të Endrit Hetemi, me numër personal 1176447008, në shumën prej 300.00 Euro/muaj;
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur dhe ndërrimit të emrit, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në kundërtën do të ndërmirën të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirim të hapësirave:
- a) Muharrem Beqiri, si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr.20A, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek BEQA Sh.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 870.15 €;
 - b) Sali Beqiri si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr.14A, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek BEQA Sh.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 2,056.22 €;
 - c) Gentrit Hetemi si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr.9, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek Endrit Hetemi, është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 831.36 €.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.

Veprimtaria e NSH Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Handwritten signature



Më datë 21.03.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26306/2025, e parashtruar nga Muharrem Beqiri, me nr. personal 1000934086 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Muharrem Beqiri të transferohet në emër BEQA SH.P.K., përfaqësuar nga Muharrem Beqiri. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 56485/2025, bëhet fjalë për tokën afariste nr.20A, me qira mujore prej 157.00€.

Më datë 21.03.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26307/2025, e parashtruar nga Salih Beqiri, me nr. personal 1000931094 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Salih Beqiri të transferohet në emër BEQA SH.P.K., përfaqësuar nga Muharrem Beqiri. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 56492/2025, bëhet fjalë për tokën afariste nr.14A, me qira mujore prej 371.00€.

Më datë 27.05.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26522/2025, e parashtruar nga Gentrit Hetemi, me nr. personal 1176446982 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Gentrit Hetemi të transferohet në emër Endrit Hetemi. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 47467/2023, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 9, me qira mujore prej 300.00€.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Në këtë rast duhet të kemi parasysh, siç është diskutuar edhe më parë, se NSh Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit. Për rrjedhojë, lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe në rastet kur nuk ka lidhje familjare ndërmjet qiramarrësit aktual dhe

Nuk është paraparë ndonjë kufizim për transferim të kontratave të qirasë, siç mund të jetë që transferimi të bëhet vetëm ndërmjet familjarëve ose partnerëve afaristë, as në këto Kontrata të Qirasë. Kushti i vetëm i domosdoshëm është pëlqimi nga ana e AKP-së.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025

Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/20

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që konform nenit 5.2 të Kontratës së qirasë 22108/15 të datës 23.02.2015 të bëjë shkëputjen e kontratës me qiramarrësin aktual N.T.P. "Art Fashion" i cili në bazë të kontratës ka në shfrytëzim lokal në sipërfaqe prej 60 m², me emimin prej 623.77 Euro për një muaj kalendarik (çmim i përcaktuar pas rivlerësimit) për aset në NSH "Tregtia", Ferizaj.
- II. Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që të njoftojnë palën Albert Sherifi se aset nuk mund ti ofrohet atij për qiramarrje, përderisa aset është në pronësi private. Mjetet e qirasë të rimbursuara deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi ruhen dhe i dorëzohen palës z. Sherifi, në rast të verdiktit përfundimtar në favor të tyre.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi çështjen e ngritur nga Autoritetit të Likuidimit për shqyrtim të kërkesës nga Albert Sherifi për kthimin e pronës private të ngastrës nr. 2141 të NSH "Tregtia", Ferizaj.

Bordi sipas sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.

- Me datë 07 nëntor 2005, Gjykata Komunale në Ferizaj bie aktgjykim i të pjesshëm me referencë C.nr. 05/02, me të cilin:
"Detyrohen të paditurit NSHT "Qarkullimi Tregtar" në Ferizaj dhe Azem Fejzullahu nga Vojnovci pronar i kafesë "Kosova" në Ferizaj që t'ia lirojnë nga njerëzit e sendet objektet që i shfrytëzojnë dhe ti dorëzojnë në posedim paditësit Shefqet Sherifit, të cilat gjenden në Ferizaj ish rr. "M. Tito" dhe "Car Urosh" pa nr. të evidentuara në fletë posedimin nr. 1096 ZK Ferizaj, në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
"Obligohen të paditurit Komuna e Ferizajit në Ferizaj NSHT "Qarkullimi Tregtar" në Ferizaj, Shoqata e Zejtarëve në Ferizaj dhe Azem Fejzullahu nga fsh. Vojnovc që paditësit ti pranojnë të drejtën e pronësisë në ndërtesat – lokalet si dhe të drejtën e shfrytëzimit të tokës ndërtimore urbane, të evidentuara e të përshkruara si ngastra kadastrale me nr. 2141 në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.03.14 ha pa kurrëfar kushtëzimi e të ngjashme".
- Kundër aktgjykimit të lartcekur, të paditurit kanë ushtruar ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Kjo e fundit, përmes aktvendimit Ac.nr. 206/2006 të datës 22 dhjetor 2008, vendosi të prish aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr. 5/2002 të datës 07.11.2005 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

M.H.



- Gjykata Komunale në Prishtinë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme nga ana e Komunës së Ferizajt dhe AKP-së, me datë 07 shkurt 2011, bie aktvendim me të cilin caktohet masa e përkohshme e sigurisë dhe ndalohet tjetërsimi apo ngarkimi me çfarëdo barre i patundshmërisë kontestuese të evidentuar si ngastra kadastrale nr. 2141, në sipërfaqe prej 314 m², e shënuar në CDPP UL-72217010-01086, ZK Ferizaj, deri në përfundimin e kontestit me vendim të formës së prerë të gjykatës.
- Kundër aktvendimit të lartcekur me datë 11 shkurt 2011, paditësi ka parashtruar kundërshtim (*shih Aneksin 8*). Gjykata Komunale në Prishtinë duke vendosur lidhur me kundërshtimin e paditësit, me datë 24 mars 2011 bie aktvendim me të cilin vërtetohet aktvendim i kësaj gjykate i datës 07 shkurt 2011, për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.
- Në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kjo lëndë është evidentuar me numrin C-III-14-0081.
- Patundshmëria kontestuese rregullisht është dhënë me qira nga ana e Ndërmarrjes. Pas hyrjes së Ndërmarrjes në proces të likuidimit, qiradhënia e lokalit afarist të NSh "Tregtia" është vazhduar nga AL të NSh "Tregtia", Ferizaj.
Qëndrimi i AL-së përkatëse është bazuar në dispozitën e nenit 27.1.1.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP (04/L-034 me ndryshime të kohëpaskohshme).

Aktualisht, parcela nr. nr. 2141 ZK Ferizaj edhe në bazë të historiatit kadastral të pranuar nga ZKK Ferizaj, hisotriat të cilin AKP nuk e kishta pranuar ndonjëherë më herët, figuron të jetë në emër të personit privat, saktësisht familjes Sherifi dhe prandaj duke qenë se aset i është në pronësi private, AKP/AL e NSh "Tregtia" Ferizaj nuk ka autoritet që të mbajë nën qira aset në fjalë. Në bazë të hisotriatit, që prej kohës që kanë shënimet. Prej vitit 1983, prona evidentohet në pronësi të z.Shefqet Sherifi.
Mbi këtë bazë parashihet që konform rregullitvës ligjore të bëhet shkëputja e kontratës së qirasë më qiramarrësin aktual "Art Fashion".

Lidhur me kërkesën e palës z.Sherifi, AKP vlerëson njëjtë që nuk ka autoritet apo kompetenca për të ju dorëzuar aset në fjalë në posedim, qoftë përmes qirasë apo formave të tjera duke qenë se prona figuron në pronësi të tyre.


AKP përmes kësaj nuk heq dorë nga pretendimet pronësore dhe vetëm në rast se Gjykata vendos në favor të palës z.Sherifi, atëherë duke qenë se e ka mbajtur deri më tani aset me qira do të bëjë rimbursimin e mjeteve tek parashtruesit e kërkesës.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
X Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/21

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 10. 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Nenet 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-210/38 të datës 30 shtator 2024, në raport me pikën I dhe II të dispozitivit të vendimit të Bordit të Drejtorëve, saktësisht nën paragrafin a) në të dy pikat e dispozitivit, si në vijim:
 - a) Lokali nr. 19 me sipërfaqe prej 25.43 m² – Tregu i Gjellbër (pranë RTK-së), sipas rivlerësimit të çmimit të qirasë nga Komisioni vlerësues dhe propozimit të Autoritetit të Likuidimit, të ketë vlerën mujore të përcaktuar për qiradhënie në shumën 93.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës Flakon Berisha.
- II. Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive parashtruesit e kërkesave para nënshkrimit të kontratave të qirasë do të duhet të paguajnë shumën sipas nën paragrafit vijues të këtij vendimi :
 - a) Lokali nr. 19 me sipërfaqe prej 25.43 m² – parashtruesi i kërkesës Flakon Berisha do të duhet të paguajë retroaktivisht për shfrytëzimin pa kontratë të qirasë nga data 01 korrik 2024 deri më 30 shtator 2024, në përputhje me çmimin e ri të rivlerësuar prej 93.00 € në muaj, në shumën totale prej 279.00 €.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e çështjes sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

Me datë 20.01.2025, Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 26020, të dorëzuar nga Flakon Berisha, qiramarrës i lokalit nr. 19 në Tregun e Gjellbër (afër RTK-së), në të cilën ai shpreh pakënaqësi ndaj vendimit të Bordit të Drejtorëve me nr. referencë BD-210/38, që kishte përcaktuar çmimin e qirasë në shumën 213.00 € në muaj, për sipërfaqen prej 25.43 m².



Në kërkesën e tij, Flakon Berisha deklaroi se hapësira është shfrytëzuar vetëm si depo/magazinë për ruajtjen e mallrave, pa ndonjë aktivitet komercial apo shërbim për klientë, dhe si e tillë, çmimi i përcaktuar është i papërbalueshëm dhe nuk përputhet me funksionin aktual të përdorimit.

Duke marrë parasysh deklarin e palës dhe faktin se hapësira nuk përmbush kushtet funksionale për veprimtari tregtare, Komisioni i Vlerësimit ka realizuar inspektim në terren, ka shqyrtuar gjendjen faktike dhe ka konstatuar se hapësira përbën njësi ndihmëse e ndërtuar me material të vrazhdë, me përdorim ekskluziv si magazinë. Bazuar në analizën krahasuese të kontratave ekzistuese dhe në aplikimin e normës së inflacionit për periudhën përkatëse, Komisioni ka propozuar rivlerësimin e çmimit të qirasë në shumën 93.00 €/muaj, me një çmim për njësi prej 3.61 €/m². Po ashtu, është rekomanduar anulimi i kërkesës për pagesën retroaktive prej 639.00 €, për shkak të mospërputhjes së destinimit real të hapësirës me vlerësimin fillestar.

Sipas vlerësimit të Autoritetit të Likuidimit dhe raportit të Komisionit vlerësues, të formuar në bazë të vendimit DE 376/2024 të Drejtorit Ekzekutiv, është realizuar rivlerësimi i qirasë për lokalin nr. 19 në Tregun e Gjelbër (afër RTK-së), pas ankesës së parashtruar nga qiramarrësi Flakon Berisha, e protokolluar me nr. 26020, datë 20.01.2025. Në përmbajtjen e raportit të hartuar më 22.05.2025, Komisioni ka konstatuar se hapësira në fjalë përbën ndërtim të thjeshtë, pa infrastrukturë të përshtatshme për veprimtari komerciale dhe është shfrytëzuar ekskluzivisht si depo/magazinë, pa zhvillim aktiviteti tregtar apo ofrim shërbimesh për klientë. Çmimi prej 213.00 €/muaj, i përcaktuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-210/38, është vlerësuar si i paarsyeshëm dhe ekonomikisht i pajustificueshëm, për shkak të mospërputhjes me destinimin real të hapësirës.

Bazuar në analizën krahasuese dhe përshtatjet për faktorët teknikë dhe ekonomikë, Komisioni ka propozuar çmimin e ri prej 3.61 €/m², që për sipërfaqen prej 25.43 m² përkon me shumën 93.00 €/muaj, vlerë e konsideruar si proporcionale dhe e drejtë për kategorinë e hapësirave ndihmëse/depo. Gjithashtu, është rekomanduar anulimi i kërkesës për pagesën retroaktive në shumë prej 639.00 €, për shkak të mospërputhjes ndërmjet vlerësimit fillestar dhe përdorimit faktik të hapësirës, si dhe për të garantuar trajtim të barabartë me qiramarrësit tjerë në kushte të ngjashme.

Në këtë drejtim, Autoriteti i Likuidimit konsideron se është e arsyeshme dhe e nevojshme të ndryshohet vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-210/38, në pikat përkatëse të dispozitivit I dhe II, dhe që kontrata e qirasë të lidhet në përputhje me vlerësimin e ri, në harmoni me nenet 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të NSh-ve nga uzurpatorët apo shfrytëzuesit e paligjshëm.


Për më tepër, duhet theksuar se hapësira në fjalë nuk është përfshirë në listën e aseteve të propozuara për përfshirje në Fondin Sovran të Republikës së Kosovës dhe, për shkak të karakterit specifik të aseteve të NSh "Tregu" (në likuidim), nuk ka qenë objekt i ndonjë procesi të qiradhënies përmes procedurës së tenderit publik. Në rast të aprovimit të këtij propozimi, kontrata e qirasë do të lidhet me efektivitet nga data 01.10.2024, në përputhje me dispozitat e vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-210/38.

Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/22

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në dhe Nenit 10.1.4 të Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist "Turist" e cila gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 76 (te sheshi i qytetit), Mitrovicë Veriore, në pronësi të NSh "Trepça Standard" me sipërfaqe prej 28.4 m2 për palën Nermine Sahatçija sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 100.00 Euro/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Ndërmarrja Shoqërore "Trepça Commerce", në Mitrovicë Veriore – MIT082, është në proces të tranzicionit. Kjo ndërmarrje është një prej njërive jo-thelbësore të KXMK Trepça, e cila sipas Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, mbetet në administrim të AKP-së dhe e njëjta posedon disa asete për të cilat AKP fokusohet kryesisht në ruajtjen dhe qiradhënien e tyre.

Më datë 03.09.2024 është pranuar kërkesa nga Nermine Sahatçija për qiramarrjen e lokalit afarist "Turist" e cila gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 76 (te sheshi i qytetit), Mitrovicë veriore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 28.4 m2.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 969/2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren, çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist "Turist" e cila gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 76 (te sheshi i qytetit), Mitrovicë Veriore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 28.4 m2, është në shumën prej 100.00 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/23

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në dhe Nenit 10.1.4 të Rregullores për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të lokalit afarist që gjendet Rr. Mbreti Petar I nr. 90 (përballë Beriljeve), Mitrovicë Veriore, në pronësi të NSh "Trepça Commerce" MIT087 me sipërfaqe prej 29.6 m² për Milica Radenkovic sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 100.00 Euro/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi duke u bazuar në faktet si në vijim.

Ndërmarrja Shoqërore "Trepça Commerce", në Mitrovicë veriore – MIT087, është në proces të tranzicionit. Kjo ndërmarrje është një prej njësive jo-thelbësore të KXMK Trepça, e cila sipas Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, mbetet në administrim të AKP-së dhe e njëjta posedon disa asete për të cilat AKP fokusohet kryesisht në ruajtjen dhe qiradhënien e tyre.

Më datë 15.05.2025 është pranuar kërkesa nga Milica Radenkovic për qiramarrjen e lokalit afarist e cila gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 90 (përballë Beriljeve), Mitrovicë veriore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 29.6 m².

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 969/2025 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren, çmimi që duhet të përcaktohet për lokalin afarist e cila gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 90 (përballë Beriljeve), Mitrovicë veriore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 29.6 m², është në shumën prej 100.00 Euro/muaj.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrëjë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


X **Mentor Hyseni**
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227-24

Në bazë të neneve 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 5 dhe 16 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Të iniciohen procedurat e likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet të paraqitura në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe miratimin e buxhetit 2 vjeçar të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet një nga një, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të nenit 16 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndryshuar me nenin 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Kategoria	Komuna	Regjioni
1	MIT052	Njësia Punuese "Bar Bilje"	Aset	Zubin Potok	Mitrovicë
2	PRN038	Kooperativa Zejtare Banesore "Bashkimi"	Ndërmarrje Shoqërore	Prishtinë	Prishtinë

- II. AUTORIZOHET Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetin e Likuidimit (AL) për Ndërmarrje Shoqërore/Aset nga pika (i) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm);
- III. Miratohet shitja e të gjitha aseteve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së", të cilat janë të listuara në dokumentet "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjet/asetet e propozuara për fillim të procedurave të likuidimit;
- IV. Vendimi për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit hyn në fuqi me datë 4 korrik 2025.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave inicimin e procedurave të likuidimit për ndërmarrjen/asetin me arsyetimin sikurse në vijim:

- i. MIT052 Njësia Punuese "Bar Bilje", aseti në Zubin Potok - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i kësaj ndërmarrje ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së. Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Aseteve dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 27 mars 2025 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS/SDR 0824), sipas nenit 5.1 të Ligjit Nr. 04/L-034. Zyra Rajonale e AKP-së në Mitrovicë nuk është në dijeni për ekzistimin e menaxhmentit të ndërmarrjes, kështu që ne nuk mund të japim informacione mbi këtë çështje. Zyra Regjionale e AKP-së në Mitrovicë konstaton se ndërtesa-fabrika është e mbyllur dhe nuk ka veprimtari në këtë ndërmarrje një kohë të gjatë. AKP ZR Mitrovicë i ka dërguar kërkesë Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për parcelën 02348-1, ZK Breg i Madh (Veli Breg). Parcela me numër 02348-1 nuk ekziston në gjendjen tekstuale dhe grafike në evidencën e Agjencisë Kadastrale

144



të Kosovës. Sipas të dhënave në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ekziston parcela 02348-0 e cila evidentohet në emër të ndërmarrjes Ibër Lepenc. Sipas dokumenteve që posedon AKP ZR Mitrovicë, besohet që eksproprijimi i pronës për ndërtimin e ndërtesës afariste-fabrikës ka ndodhur pas vitit 1990. Sipas dokumentit të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Serbisë me datën 14.08.2002 parcela numër 02348-1 evidentohet në emër të "D.P. BAR-BILJE Export-Import" me kod të regjistrimit të pronës në vitin 1994. Kurse sipas dokumentit të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Serbisë me datën 04.06.2007 prona në fjalë evidentohet në emër të "Preduzece DIKODIL D.O.O. Zubin Potok". Në vitin 2003, është nënshkruar kontrata për shitblerjen e asetit të Bar Bilje ndërmjet Milan Vukadinoviq, përfaqësues i ndërmarrjes në falimentim dhe Manastirit Duboki Potoci në Dioqezën Ortodokse Serbe Rashkë-Prizren dhe Kosovë. Kontrata është vërtetuar në një gjykatë jashtë Kosovës, respektivisht në Gjykatën Ekonomike në Podgoricë. Në vitin 2005, Dioqeza Ortodokse Serbe Rashkë-Prizren ka ndryshuar strukturën e kapitalit aksionar duke mbajtur 49% të aksioneve dhe duke ndarë 51% për tre aksionarë privatë.

- ii. PRN038 Kooperativa Zejtare Banesore "Bashkimi" - Prishtinë - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i kësaj ndërmarrje ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së. Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Aseteve dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 28 prill 2025 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS/SDR 1367), sipas nenit 5.1 të Ligjit Nr. 04/L-034.

Sipas informatave që disponon ZR Prishtinë, asetet e KZB "Bashkimi" të identifikuar deri më tani janë: Ngastra 1499/4 me sipërfaqe 6,250 m² (62 ari 50 m²), Zona Kadastrale Prishtinë, Lokal afarist me sipërfaqe 230.6 m² në lagjen Dardania BL9, L-A, Nr.1, Prishtinë, Lokal afarist me sipërfaqe 94.32 m² dhe hapësirat përcjellëse me sipërfaqe 10.66 m² dhe 19.09 m², rr. UÇK, Objekti A, kati 1, Prishtinë, Lokal afarist me sipërfaqe 81 m², rr. Vuçiternska nr.12, Prishtinë. Në bazë të certifikatës pronësore, aktualisht ngastra kadastrale 1499-4 ZK Prishtinë, me sipërfaqe 6250m² është në pronësi private të Nuhi (Ibrahim) Sfarqa. Në certifikatë është e shënuar vërejtja ku thuhet se prona ka kaluar në pronësi të z. Nuhi Sfarqa në bazë të kontratës së "dhuratës". Meqenëse ish-drejtori i KZB "Bashkimi" ka pretenduar se ky entitet është privat, ka kryer marrëveshje të shit-blerjes për lokalet afariste me palë të treta për të cilat duhet të hulumtojmë më tutje rreth çështjes së pronësisë të lokaleve afariste që kanë qenë në pronësi të KZB "Bashkimi". Prandaj, mund të shfaqen edhe çështje tjera pronësore të cilat ndikojnë në ndërmarrjen.

Sipas listës së asetëve nga Ndërmarrja dorëzuar AKM-së në vitin 2004, përveç pronës së lartpërmendur, ka prona të tjera, kryesisht ndërtesa të cilat janë të ndërtuara mbi prona publike dhe pyjore. Gjithashtu, një pronë është evidentuar në zonën kadastrale Crnac - Novi Pazar e që mund të jetë aset jashtë Kosovës.

Duke marrë parasysh faktet si më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/25

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dhe nenit 3.10.4 i Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-70705028-05314-3 me sipërfaqe prej 2850 m² dhe P-70705028-05314-4 ZK Gjakovë, lokacioni jashtë qytet me sipërfaqe prej 2630 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet e NSh "Ereniku – Prodhimtaria Primare" PEJ029.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete do të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht ngastrat me nr. P-70705028-05314-3 dhe P-70705028-05314-4 ZK Gjakovë lokacioni jashtë qytet të NSh "Ereniku – Prodhimtaria Primare" PEJ029.

Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastra kadastrale nr. 05314-3 dhe 05314-4 ZK Gjakovë lokacioni jashtë qytet janë ngastra për heqje dorë për faktin se këto parcela janë evidentuar në bazë të gjendjes faktike në terren se shfrytëzohen për varreza. Në këtë parcelë janë varrezat e martirëve në Çabrat. Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se asetet nuk janë në gjendje të kenë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se këto parcela shfrytëzohen si varreza, të cilat i shërbejnë interesit publik të komunitetit të caktuar.

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-227/26

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Rregullores Nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve, nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dhe Nenit 3.10.4 i Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 qershor 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aset nr. P-70505021-01200-0 ZK Deçan me sipërfaqe prej 215 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga asetet e NSh "NT Agimi" PEJ134.
- II. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, këto asete të kalojnë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhen paluajtshmëritë në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- III. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetet respektivisht nga ngastra nr. P-70505021-01200-0 ZK Deçan në pronësi të NSh "NT Agimi" PEJ134


Ky aset është rast për heqje dorë për faktin se ngastra kadastrale nr. P-70505021-01200-0 ZK Deçan me sipërfaqe prej 215 m² që është objekt i kësaj kërkesë sipas gjendjes faktike është evidentuar si lapidar, saktësisht është i ndërtuar memoriali i dëshmorëve të asaj zone.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se asetet nuk janë në gjendje të kenë realizim fitimprurës dhe në të njëjtën kohë nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv për arsye se këto parcela shfrytëzohen si varreza, të cilat i shërbejnë interesit publik të komunitetit të caktuar.

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 qershor 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit